



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU-DEJES

V E N D I M

Nr. 19 , Datë 16/04/2016

Për

Miratimin e nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur, të emëruar, nepunesit civil dhe punonjësit administrativ të Bashkisë Vau-Dejes për vitin 2016

Mbështetur në nenin 53 pika 2, nenin 54 germa ç, e Ligjit Nr. 139 datë 17.12.2015 “Për veteqeverisjen vendore” ; Ligjin Nr.9936 datë 26/06/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”; neni 15 i Ligjit Nr.147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”; Ligjin Nr.10405 datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM Nr.165 datë 02.03.2016 “Per grupimin e njesive të veteqeverisjes vendore ,per efekt page ,dhe caktimin e kufijeve të pagave të funksionareve të zgjedhur të emeruar ,te nepunesve civile e te punonjesve administrative te njesive të veteqeverisjes vendore”; VKM nr.624 date 24.07.2013 “Per nje ndryshim ne vendimin nr.194 date 22.04.1999 te Keshillit te Ministrave “Per miratimin e struktures se pages se punonjesve mesimor ne arsimin parauniversitar “ te ndryshuar; VKM nr.610 date 24.07.2013 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.717,date 23.06.2009 te Keshillit te Ministrave “Per pagat e punonjesve mbeshtetes te institucioneve buxhetore “ te ndryshuar; Udhëzimit plotësues Nr.2 datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”; VKM Nr.965 datë 02.12.2015 “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave”; Vendim Nr.941, datë 15.07.2015 i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, Keshilli i Bashkisë, pasi shqyrtoi dhe diskutoi materialin e paraqitur ,në mbledhjen e tij të datës 16 /04/2016 me shumice votash :

V E N D O S I :

- 1.Të miratojë nivelin e pagave për funksionarët e zgjedhur, të emëruar, nepunesit civil dhe punonjësit administrativ të Bashkisë Vau-Dejes për vitin 2016, sipas lidhjeve bashkengjitur;
2. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data 01/02/2016 deri me datë 31/12/2016.
3. Ngarkohet drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
- 4.Fondi i pagave perballohet nga transferta dhe te ardhurat .
- 5.Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 te ligjit 139/2015.
- 6.Ky vendim u shpall me date 25/04/2016

SEKRETARI
Gentian Ndoj



KRYETARI
Martin Marku